



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KESHILLI I BASENIT UJËMBLEDHËS SEMAN

VENDIM

Nr. 2 ,datë 07.02.2020

PËR

MIRATIMIN NË PARIM, PËR PERDORIMIN TË BURIMIT UJOR TË PËRROIT TË SHARRËS, DEGË E LUMIT DEVOLL, PËR PRODHIM HIDROENERGJIE, NGA SUBJEKTI " HIDRO VALA " SH.P.K, NË BASHKINË GRAMSH, QARKU ELBASAN.

Në mbështetje të nenit 50, pika 2, të ligjit nr.111/2012, i ndryshuar me ligjin 6/2018, datë 8.2.2018, për "Menaxhimin e integruar të burimeve ujore" VKM nr. 221, datë 26.4.2018 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore ", si dhe të VKM Nr. 416, datë 13.5.2015 si dhe Vendimit të Këshillit Kombëtar të Ujit Nr. 6 datë 12.6.2019, "Për miratimin e rregullores", "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor" , "Për pajisjen me autorizim (miratim në parim)" të subjektit "HIDRO VALA" sh.p.k me propozim të Z.A.B.U. Shkumbin-Seman.

Këshilli i Basenit Ujor Seman,

V E N D O S I:

1. Shtyrjen e miratimit në parim të burimit ujor të Përroit të Sharrës, degë e lumit Devoll, për prodhim hidroenergjie nga subjekti " HIDRO VALA " sh.p.k, në Bashkinë Gramsh, Qarku Elbasan. **Shtyrja e vendimit u vendos që të saktësohet qartë nga Agjencite e Zonave të Mbrojtura nëse lejohet zhvillimi i kësaj veprimtarie ose jo.**
2. Ngarkohet Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Shkumbin-Seman për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I K B U S E M A N

BAKI BALA

